



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**  
**Sekretaria**

Nr. Prot.

Tiranë, më .08.2024

**MBLEDHJA Nr. 32,**  
**Datë 03.09.2024, ora 09:00**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Martë, datë 03.09.2024, ora 09:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 32 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e Kontratës Tip ndërmjet shoqërive KESH sh.a. dhe FTL sh.a. për shitjen/blerjen/depozitimin/shkëmbimin e energjisë elektrike.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekës) të asetëve të paluajtshme të saj.
3. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**